

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

MARRËVESHJE

Mbi Shfrytëzimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Telekomunikuese e Lidhur Ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Telekomit të Kosovës Sh.A.

(Kontrata MPBAP prot. Nr. 1195, dt.29.07.2022 dhe TK Sh.a prot. Nr. 01-3352/22, dt. 28.07.2022)

Pjesa I: Shfrytëzimi i Kontratës

1. Komuna e Vushtrrisë Adresa: Rr. Sheshi Ahmet Krasniqi Nr. 10 Numri fiskal: 600535001 ; Xhirollogaria Nr.1000650310000041 Banka Qendrore e Kosovës, në Prishtinë të cilën e përfaqëson z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës (në vazhdim "Marrësi i Shërbimeve"), në njërën anë;

Dhe

2. Telekomit i Kosovës Sh.A.; Adresa: Dardania P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë; Numri Unik Identifikues (NUI): 811288001; Xhirollogaria dhe Banka: 1700200100070207 në NLB Banka Sh.A.: të cilën ligjërisht e përfaqëson Burbuqe HANA,U.D Kryeshefe Ekzekutive e Telekomit të Kosovës Sh.A. (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër,

Janë pajtuar, që duke u bazuar në Nenin 1 (Pjesa I e Kontratës), të lidhin këtë Marrëveshje mbi Shfrytëzimin e Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve Telekomunikuese në vijim:

"KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TELEKOMUNIKUESE PËR KOMUNËN E VUSHTRRIË"

Palët përmes nënshkrimit konfirmojnë pajtueshmërinë e tyre të plotë me lëndën e kësaj kontrate, dokumentet e saj përbërëse, duke përfshirë kushtet, çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve.

Pagesa e faturave të krijuara në baza mujore bëhet nga Komuna e Vushtrrisë duke u bazuar në produktet dhe shërbimet e përzgjedhura telekomunikuese.

Marrëveshja hynë në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët dhe bëhet pjesë përbërëse e Kontratës, e cila duke u bazuar në Nenin 7 (Pjesa I e Kontratës), ka kohëzgjatje prej gjashtëdhjetë (60) muajve, duke filluar prej 29/07/2022 e deri më 29/07/2027.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në Gjuhën Shqipe në katër origjinale, dy origjinale për Marrësin e Shërbimeve dhe dy origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.


"KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TELEKOMUNIKUESE PËR INSTITUCIONET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS"


Faqe 1 nga 2

1.1 Implementimi

Kushtet për implementimin e ofertës Klubi IRK:

- Kjo ofertë do të shfrytëzohet nga të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK), si Autoritete Kontraktuese (Autoritete Publike).
- Kërkesa për shfrytëzimin e kësaj oferte nga IRK-të bëhet zyrtarisht përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), ndërsa faturimi dhe pagesa e faturave të krijuara në baza mujore bëhet nga IRK-të veç e veç, duke u bazuar në pakon e përzgjedhur postpaid-prepaid dhe vlerën e mbushjeve të Vala.
- Numri i anëtarëve (përdoruesve mobil postpaid dhe prepaid) në Klub (CUG) të IRK-ve përcaktohet sipas kërkesës/porosisë, me mundësi ndryshimi.
- IRK-të mund të shfrytëzojnë Paket Postpaid (Mujore) të prezantuara në ofertë, sipas kërkesës/porosisë, me mundësi ndryshimi.
- IRK-të mund të shfrytëzojnë Paket Prepaid (Mujore) të prezantuara në ofertë (IntM_CUG dhe IntL_CUG), sipas kërkesës/porosisë, me mundësi ndryshimi.
- Numrat Prepaid (anëtarët në CUG), me kërkesë zyrtare, duhet të kreditohen/ngarkohen së paku me 2.00 Euro me TVSh mbushje elektronike në baza mujore për thirrje jashtë Klubit (CUG), e cila do të ruajë statusin aktiv të tyre për 31 ditë, me përjashtim të Numrave Prepaid (Numrave Kujdestar) për të cilët palët merren vesh që kjo ngarkesë të jetë 0.00 Euro. Kjo mundëson komunikim pa pagesë me të gjitha IRK-të, të cilat e shfrytëzojnë këtë ofertë.
- Numrat Prepaid (anëtarët në CUG), të cilët me kërkesë zyrtare nuk kreditohen/ngarkohen me mbushje elektronike në baza mujore, për të realizuar thirrje brenda dhe jashtë Klubit (CUG), duhet të ruajnë statusin aktiv sipas tarifave dhe afateve të rregullta të përcaktuara nga TK-Vala. Kjo mundëson komunikim pa pagesë me të gjitha IRK-të, të cilat e shfrytëzojnë këtë ofertë.
- Numrat Prepaid (anëtarët në CUG), me kërkesë zyrtare, mund të ngarkohen me Data Paket (Internet 3G/4G) Mujore për Prepaid, sipas tarifave të prezantuara në ofertë.
- Numrat Prepaid (anëtarët në CUG), të cilët me kërkesë zyrtare nuk ngarkohen me Data Paket (Internet 3G/4G) Mujore për Prepaid mund të blejnë Data Paket (Internet 3G/4G) sipas tarifave dhe afateve të rregullta të përcaktuara nga TK-Vala.
- IRK-të furnizohen vetëm me mbushje elektronike të TK-Vala në baza mujore, sipas kërkesës/porosisë, me mundësi ndryshimi plus/minus

Për Marrësin e Shërbimeve:	
Emri:	FERIT IDRIZI
Pozita:	KRYETAR I KOMUNËS
Nënshkrimi:	
Data:	27.09.2022
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve:	
Emri:	Kreshnik Domi
Pozita:	Drejtor i Shitjes i Telekomit të Kosovës Sh.A.
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

